ZRRUK/UTSH/USH – 05/05-05/2013
11 Shkurt 2013

Në pajtim me autoritetin e dhënë me *Ligjin Nr. 03/L-086*, *Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësi dhe Kanalizimit*, datë 15 qershor 2008 *me të cilën është amendamentuar Rregullorja 2004/49* ("Ligji")

Konform Nenit 15 të *Rregullës për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë,* datë 24 dhjetor 2012 (Rregulla - ZRRUK R 02/U&K),

Duke u bazuar në të dhënat e aplikacionit për Tarifë Shërbimi të ujit me shumicë të trajtuar dorëzuara nga KRU 'MITROVICA" Sh. A. Mitrovicë gjatë fillim vitit 2012 dhe në procesin e zhvilluar të analizave dhe të vlerësimit të tyre,

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim ("ZRRUK") lëshon këtë:

URDHËRESË TARIFORE SHËRBIMI

PËR TARIFËN E UJIT TË TRAJTUAR ME SHUMICË QË DUHET TË APLIKOHET NGA KRU "MITROVICA" SH. A. MITROVICË, PER FURNIZIM TE PJESËS VERIORE TË QYTETIT TË MITROVICËS GJATË VITIT TARIFORË 2013 NGA PROCESI RREGULLATORË I TARIFAVE TË VITEVE 2012-2014

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë Tarifore të Shërbimit, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që iu atribuohen Rregullës ZRRUK - R 02/U&K.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifës së Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për aplikim nga KRU "MITROVICA" Sh. A. Mitrovicë, të cilës i kërkohet të aplikoj tarifën e shërbimit sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit me rastin e faturimit të Ujit me Shumicë të Trajtuar për pjesën veriore të Qytetit të Mitrovicës.

3. Lista e Tarifave të Shërbimit

Gjatë vitit tariforë 2013 të periudhës së procesit rregullatorë 2012 - 2014, KRU "MITROVICA" Sh. A., Mitrovicë, do të furnizojë pjesën Veriore të Qytetit të Mitrovicës me ujë të trajtuar me shumicë me tarifën e vitit 2013 të pasqyruar në tabelën e më poshtme, kolona 5.

Tabela 1. **Tarifa e procesit rregullatorë për aplikim gjatë vitit 2013**, nga procesi rregullatorë 2012-2014

Numër Rendor	Përshkrimi i shërbimit me ujë	Njësia matëse	Tarifa historike e vitit 2012 me IÇKK për vitin 2012	Tarifa e vitit 2013 me IÇKK – ASK, indeksi tetor/2010-dhjetor2012	Tarifa e vitit 2014 pa IÇKK - ASK
1	2	3	4	5	6
1	**Ujë me shumicë të trajtuar**	**m3**	**0.16**	**0.17**	**0.155**

Sqarim: IÇKK – Indeksi i Çmimeve të Konsumit në Kosovë (IÇKK)
ASK – Agjensioni i Statistikave të Kosovës
Tarifa e aplikuar është pa TVSH.

4. Aplikimi i tarifës

Tarifa e Shërbimit për furnizim të ujit me shumicë të trajtuar e aprovuar sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit do të aplikohet;

1. Për vitin 2013 nga: **1 janari 2013 gjer me 31 dhjetor 2013** faturimi i furnizimit të ujit me shumicë të trajtuar do të bëhet me tarifën **prej 0.17 €m3.** Kjo tarifë është përshtatur me IÇKK - ASK për periudhën e shikuar të indeksimit të Çmimeve të Konsumit në Kosovë; tetor/2010 (116.6) – dhjetor/2012 (127.0), e cila është identifikuar të jetë 1.08919.
2. Tarifa e vitit 2014 do të përshtatet me lëvizjen e shkallës së IÇKK për periudhën dhjetor/2013-tetor/2010.

Tarifa e vitit 2014 do të përshtatet me lëvizjet inflatore që do të ndodhin edhe gjatë vitit 2013.

3. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifës së Shërbimit

KRU "MITROVICA" Sh. A., Mitrovicë është e obliguar të njoftojë marrësin e Shërbimit të Ujit të Trajtuar me Shumicë, me tarifën e aprovuara sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit dhe të bëjë nënshkrimin e Kontratës për këtë shërbim me te dhe së paku një herë në vit të njëjtën duhet ti bashkëngjisë faturës për ujin e furnizuar.

4. **Apelet**

KRU "Mitrovica" sh. a. ka të drejtë të apelojë në afatin kohorë prej 15 ditëve të punës në rast mospajtimi me këtë UTSH-ë tek Komisioni për Shqyrtim që themelohet konform nenit 34. Komisioni shqyrtues, pika 34.1., Ligji Nr. 03/L-086 m*bi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit,* të datës 15 qershor 2008.

6. Gjuha Zyrtare e Urdhëresës së Tarifave

Kjo Urdhëresë e Tarifave nxjerrët dhe publikohet në tri (3) versione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë:
1) Shqip,
2) Serbisht, dhe eventualisht në
3) Gjuhen Angleze.

Në rast të mospërputhjeve në mes të versioneve, do të mbizotërojë versioni i Gjuhës Shqipe.

.....
Raif Preteni, Drejtor i ZRRUK-ut